



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr 362/5 akti

Tiranë 17.06, 2015

V E N D I M

Nr 58 Datë 17/06/2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit
nr. 362/1 dt. 19.05.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**

Bazuar në Urdhrin e verifikimit nr. 362/1 prot., datë 19.05.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "Për verifikimin e aktit nr.10 datë 02.02.2015 "Për lirimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit" të punonjësit ***** , në lidhje me pretendimet e tij për llogaritjen e masës së shpërblimit në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndyshuar me ligjin nr.178/2014 neni 17 pika 2, gërma "d" të tij, si dhe mbështetur në nenin 13, 14 gërma "a" dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit" miratuar me Vendimin nr.17 datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

VËREJ

Me Urdhrin nr.19 datë 25.11.2013 "Për komandimin e inspektorit në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës" të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, ka filluar marrëdhënia e punës së punonjësit ***** . Në përmbajtjen e këtij akti theksohet: " ***** emërohet në detyrën e inspektorit në IMT në Këshillin e Qarkut Vlorë, deri në kryerjen e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion. Marrëdhëniet financiare fillojnë nga data 01.12.2013", nga ku rezulton se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune të zakonshme, që është lidhur sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Me fillimin e efekteve të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin Civil" në dt. 26.02.2014, në bazë të nenit 67 të tij dhe Kreut II, pika 2, të VKM nr. 116, datë 05.03.2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil" këtij punonjësi i ka lindur e drejta e përfitimit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove, për shkak të ligjit. Për këtë

arsye, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale pranë Këshillit të Qarkut Vlorë, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 26 prot., datë 11.07.2014, *“Për konfirmimin e Statusit të Nëpunësit Civil”* për punonjësën ***** , në pozicionin inspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës.

Me miratimin e strukturës së re, me Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 41 dt. 17.12.2014, për shkak të shkurtimit të fondeve buxhetore, është vendosur që në këtë institucion të shkurtohen dukshëm pozicionet e punës, duke mbetur vetëm 8 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, nga 29 të tilla që përmbante struktura e mëparshme e miratuar me vendimin nr. 03, datë 04.02.2014 *“Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Vlorë, për vitin 2014”*.

Në kuadër të këtij ristrukturimi, njësia përgjegjëse, si organi që drejton procesin nga ana ligjore, ka dalë me vendimin për lirim nga shërbimi civil të atyre nëpunësve të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës. I prekur prej këtij procesi ka qënë dhe punonjësi në fjalë, prandaj me vendimin nr. 10 datë 02.02.2015, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Politikave Sociale, ka urdhëruar lirim nga detyra si pasojë e ristrukturimit, duke llogaritur me këtë rast edhe masën e dëmshpërblimit sipas vjetërsisë në shërbimin civil, në zbatim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152 “Për nëpunësin Civil”* dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave. Ky detyrim pasqyrohet në Urdhërin e Brendshëm nr.06 datë 29.01.2015 *“Për dëmshpërblimin e punonjësve civil të larguar për shkak të ristrukturimit”* të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Me pretendimin se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore i ishte llogaritur gabim vjetërsia në punë, nëpunësi ***** ka kundërshtuar përmbajtjen e aktit nr. 6 dt.29.01.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, duke kërkuar për këtë ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Nga hetimi administrativ i kryer, rezultoi se pretendimi i punonjësit ***** në lidhje me llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, duke marrë për bazë vjetërsinë prej 13 vjet pune, ishte rezultat i një interpretimi të gabuar të ligjit përse i përket vjetërsisë në punë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mbledhur, në lidhje me kohën e vjetërsisë në punë në shërbimin civil, koha e llogaritur nga njësia e burimeve njerëzore të Këshillit të Qarkut Vlorë ishte konform përcaktimeve ligjore, edhe pse punonjësi kërkonte të llogaritej si vjetërsi në shërbimin civil edhe periudha që ai kishte punuar në pozicione jashtë shërbimit civil.

Ndërkohë, pas verifikimeve dhe konsultimeve të bëra nga ana e tij, nëpunësi ***** , me një kërkesë me shkrim paraqitur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, kërkoj përfundimin e procesit të verifikimit dhe procedimit administrativ.

Nisur nga sa më sipër, konstatohet se në rastin konkret, nga subjekti Këshilli i Qarkut Vlorë, janë kuptuar dhe vlerësuar drejt rrethanat e rastit dhe janë respektuar kërkesat e nenit 50 të ligjit

nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, prandaj nuk ka vend për vazhdimin e procedimit administrativ.

Për këto arsye

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* të ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores *“Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”* të miratuar me Vendimin nr.17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

Përfundimin e procedimit administrativ të Urdhërit të Verifikimit nr. 362/1 datë 19.05.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Për verifikimin e aktit nr. 10 datë 02.02.2015 “Për lirimin nga Shërbimi Civil për shkak të ristrukturimit”*”.

Të njoftohen për këtë vendim, njësia e burimeve njerëzore në Këshillin e Qarkut Vlorë dhe shtetasi ***** .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA